



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
Ministri



Tirane, m<

2010

URDHER

PER

**PRANIMET E REJA NE SHKOLLAT E MESME ARTISTIKE, TE GJUHEVE TE HUAJA,
PEDAGOGJIKE, SPORTIVE, PROFESIONALE DHE SEKSIONET DYGJUHESHE DHE
ZHVILLIMIN E
KONKURSEVE NE SHKOLLAT E MESME ARTISTIKE DHE SPORTIVE**

Ne mbeshtetje te nenit 102 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, neneve 121 dhe 122 te Ligjit Nr. 8485, date 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", Ligjit Nr. 7952, date 21.06.1995, "Per sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 8872, date* 29.03.2002, "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republikën e Shqiperise", i ndryshuar,

URDHEROJ:

1. Shkollat e mesme artistike, te gjuheve te huaja, pedagogjike, sportive, profesionale dhe seksionet dygjuheshe, ne vartesi te kuadrit, mjediseve shkollore dhe kapaciteteve te konvikteve, te planifikojne numrin e nxenesve qe do te pranohen.
2. Shkollat e mesme artistike, te gjuheve te huaja, pedagogjike, sportive, profesionale dhe seksionet dygjuheshe, pas miratimit nga DAR/ZA, nje kopje te planit te pranimeve te reja, afatet e aplikimit, datat e regjistrimeve dhe datat e konkurimeve t'i afishojne ne ambiente te dukshme nje muaj perpara regjistrimit dhe nje jave para konkurimit.
3. Shkollat te pranojne regjistrime jo vetem nga qarku te cilit i perket shkolla, por edhe nga qarqe te tjera te cilat nuk kane shkolla te profileve te siperpermendura.
4. Pranimet e reja per shkollat e mesme pedagogjike, tekniko-profesionale, te gjuheve te huaja, si dhe ne seksionet dygjuheshe, ne perputhje me memorandumet perkatese, te behen pa konkurs.

5. Ne shkollat e mesme artistike, ne shkollen e mesme te futbollit "L. Bori9i" Tirane' dhe ne shkollen e mesme sportive "B. Qeraxhia" Durres, konkurrimi te zhvillohet sipas fushave te specialitetit. Dorezimi i dokumentacionit te behet:

a. Ne shkollat e mesme artistike deri me date 20 korrik, ndersa konkurrimi te filloje me date 25 korrik dhe te vazhdoje jo me shume se nje jave, sipas programeve te hartuara nga drejtorite e shkollave dhe te miratuara nga DAR perkatese;

b. Ne shkollen e mesme te futbollit "L. Bori9i" Tirane dhe ne shkollen e mesme sportive "B. Qeraxhia" Durres, dorezimi i dokumentacionit te behet deri me date 6 gusht ndersa konkurrimi te filloje me date 11 gusht dhe te vazhdoje jo me shume se nje jave, sipas programeve te hartuara nga drejtorite e shkollave dhe te miratuara nga DAR perkatese.

6. Dokumentet per aplikim per cdo kandidat te jene:

- a) Kerkesa per degen qe do te studioje.
- b) Fotokopje e noterizuar e defteses se lirimit e firmosur ne DAR/ZA.
- c) Kopje e kartes se identitetit e vulosur nga shkolla, ku kandidati ka marre deftesen e lirimit.

7. Afati kohor i dorezimit te dokumentacionit ne shkollat e mesme pedagogjike, tekniko-profesionale, te gjuheve te huaja, si dhe ne seksionet dygjuheshe, te jete deri me 25 gusht.

8. Kriteret e pranimeve te reja, kur shkollat kane kerkesa me shume se kapacitetet e planifikuara, te jene:

- a) Nota mesatare e lendeve te defteses se lirimit
- b) Nota e dy lendeve, te cilat shkolla i vendos per perzgjedhjen e kandidatit.

9. Kandidatet te informohen per cdo procedure nga shkollat perkatese nepermjet afishimit te dokumentacionit perkatese.

10. Drejtoria e shkolles, mbeshtetur ne numrin e kandidateve, organizon dhe perfundon perzgjedhjen e nxene'sve deri me 30 gusht.

11. Shkollat te cilat nuk plotesojne kuotat e nevojshme, te vijojne pranimet dhe regjistrimet deri me 5 shtator.

12. Nxenesit te cilet nuk rezultojne fitues ne shkollen ku kane aplikuar, kane te drejte te aplikojne per regjistrim ne nje shkolle tjeter deri me 5 shtator.

13. Shkofiat e mesme profesionale dhe ato te gjuheve te huaja ku perfshihen edhe seksionet dygjuheshe, ngrene komisionet per perzgjedhjen e kandidateve. Komisioni i ngritur nga drejtoria e shkolles perkatese eshte nen pergjegjesine e plote te drejtorit te shkolles per perzgjedhjen e kandidateve. Procesi monitorohet nga perfaqesuesi i DAR/ZA-se perkatese.

14. Ne perfundim te procesit, komisioni harton procesverbalet, te cilat te jene te vecante per secilin specialitet. Ne procesverbal perfshihen te gjitha kandidatet, te radhitur nga vleresimi maksimal te vleresimi me i ule't.

15. Procesverbalin e hartuar ne 4 kopje e nenshkruajne te gjithë anetaret e komisionit.

16. Nje kopje e procesverbalit, se bashku me listat e nxenesve fitues te zyrtarizuara nga drejtori i shkolles, sillet ne Drejtorine e Edukimit Parauniversitar (DEPU) ne Ministrine" e Arsimit dhe te Shkences, nje kopje dergohet ne DAR/ZA-te' perkatese, nje kopje ruhet ne drejtorine e shkolles dhe nje kopje behet publike.

17. Te gjitha konkurrimet te monitorohen nga DAR perkatese si dhe nga MASH-i.


18. Fitojne te drejten per t'u regjistruar ne shkolle kandidatet te cilet plotesojne kriteret e vendosura nga komisioni, sipas pikave 6 dhe 8 te ketij Urdhri.

19. Nxenesi fitues konsiderohet i regjistruar ne shkolle'n perkatese dhe duhet te paraqitet aty ditën e fillimit te vitit te ri shkollor. Nxenesi fitues qe, per arsye shendetesore te vertetuara me raport mjekesor, nuk paraqitet ne shkolle me fillimin e vitit shkollor, per te ruajtur vendin, duhet te njoftoje drejtorine e shkolles brenda 5 diteve te fillimit te mesimeve. Kur nje nxenes fitues nuk paraqitet ne shkolle brenda 10 diteve te para te fillimit te vitit shkollor, nxenesi tjetër, sipas radhes ne listen e rezultateve perkatese, gezon te drejten e pranimit ne kete shkolle, pa cenuar planin e pranimeve te reja.

20. Urdhri Nr. 307, date 31.07.2006 "Per konkurset e pranimeve te reja ne shkollat e mesme te gjuheve te huaja, artistike, sportive, teknike e profesionale" dhe Rregullorja nr. 5106, date 30.07.2004, "Per pranimet e reja me konkurs ne shkollat e mesme social-kulturore dhe teknike" shfuqizohen.

21. Per zbatimin e ketij Urdhri ngarkohen Sekretari i Pergjithshem, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar dhe DAR/ZA-te perkatese.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

MYQEREM TAFAJ

MINISTËR